

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve K. M., Y. B. dhe H. M., që të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson S. M., avokate në Prishtinë, kundër të paditurës K. e S. “S.”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K. P. punëtor i së njëjtës, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4525/2014 datë 6.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.3.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4525/2014 datë 6.11.2018.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4525/2014 datë 6.11.2018, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.883/2014 datë 20.5.2014, në pjesën I të dispozitivit, me të cilin është obliguar e paditura që paditësit : K. M. t’ia paguaj në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 1.300 €, për frikën e pësuar shumën prej 1.100 €, në emër të dëmit material për shpenzimet e shërimit shumën prej 4 €; paditësit Y. B.: në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 1.300 €, për frikën e pësuar shumën prej 1.100 €, në emër të dëmit material për shpenzimet e shërimit shumën prej 4 €; paditësit H. M. për dëmin e shkaktuar në automjetin e markës Golf, me targa të regjistrimit ..., shumën prej 1.136,35 €, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar vetëm lidhur me kamatën e gjykuar, ashtu që paditësve ju është gjykuar kamata vjetore të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 20.5.2014, e gjer në pagesën definitive. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar ka mbetur e paprekur.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, ashtu që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët t'i prishë dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave ka vërtetuar se më datë 23.4.2014, në rrugën ''Dëshmorët e Kombit'' në Prishtinë, është shkaktuar ndeshje zinxhirore, ashtu që i siguruari i të paditurës duke mos mbajtur distancën e sigurt me veturën e cila ka qarkulluar para tij e të cilën e ka drejtuar këtu paditësi K. M., e ka goditur në pjesën e prapme të automjetit, i cili nga inercioni pastaj me pjesën e përparme të automjetit e ka goditur në pjesën e prapme të automjetit para tij, me ç'rast ka pësuar dëm material në pjesën e prapme dhe të përparme të automjetit, ndërsa paditësit K. M. dhe Y. B. kanë pësuar lëndime të lehta trupore. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë dhe paditësve në seancën kryesore më datë 20.5.2014 u ka ofruar ofertën në lartësi prej nga 1000 € për lëndimet e pësuar, ndërsa nuk e ka kundërshtuar mendimin e ekspertit të komunikacionit.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material dhe material për dy paditësit, ndërsa ka vlerësuar se lidhur me kamatën gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale dhe në këtë pjesë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve pjesërisht është e bazuar. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur ka vërtetuar shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë për kompensim të cilat duhet t'i paguajë e paditura paditësve, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike drejt janë zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material, ngase, shumat e gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga eksperti Dr. Xh. S. – ortoped traumatolog dhe Dr.N. M. – neuropsikiatër, në bazë të intensitetit të dhimbjeve fizike dhe frikës së pësuar. Vërtetimi i shpërblimit (satisfaksioni) për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësve, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikën për dy paditësit, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës, e duke pasur parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit paditësve nga ana e gjykatave të instancës më të ulët sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale.

Pretendimet e cekura në revizion se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë marrë për bazë ekspertizën e komunikacionit e cila ka konstatuar se lidhur më dëmin material të shkaktuar

në pjesën e përparme të automjetit të paditësit H. M., përgjegjësia është e ndarë, për shkak të mos mbajtjes të distancës së sigurt, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase në aktgjykimet e kundërshtuara është arsyetuar fakti se gjykata ka obliguar të paditurën për shumën e dëmit në pjesën e përparme të automjetit, duke marrë për bazë kontributin e paditësit 50%, dhe nga shuma e përgjithshme e dëmit ka zbritur shumën prej 50 %, duke obliguar të paditurën vetëm për shumën prej 317,95 €, për dëmin e shkaktuar në pjesën e përparme të automjetit, ndërsa për dëmin e shkaktuar në pjesën e përparme të automjetit, sipas lëshimeve të siguruarit të paditurës, gjykata ka gjykuar shumën prej 818,40 €, ashtu që kompensimi i përgjithshëm për pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit është në shumën prej 1.136,35 €.

Gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën, në kuptim të nenit 277 të LMD –ës, nga marrja e aktgjykimit më 20.5.2014 e gjerë në pagesën definitive, konformë dispozitës ligjore nga neni 195.1 lidhur me nenin 201 par.1 pika (d) të LPK –ës.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 12.3.2019, Rev.nr.75/2019

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku